



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:230021
Datë: 24.02.2025
Numri i dokumentit: 06893973

C.nr.2036/23

GJYKATA THEMELORE GJILAN, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale, Ronita Halimi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës, Sh (H) A., me adresë në Gj., Lagjja D.. II, me objekt të kontestit pasurim pa bazë, vlera e kontestit 100 Euro, jashtë seancës, më datë 24.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Konsiderohet e tërhequr padia e paditëses, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër të paditurës, Sh (H) A.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë është në procedurë lënda e paditëses Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve kundër të paditurës, Sh (H) A., me objekt të kontestit pasurim pa bazë. Meqë shkresat e dërguara në adresën e të paditurës si në padi, janë kthyer të pa dorëzuara me konstatimin se adresa është jo e plotë, me aktvendimin e datës 20.01.2025, paditëses i është kthyer në plotësim padia për ta plotësuar me adresën e të paditurës, pasi në padi nuk ishte shënuar emri i rrugës e as numri i shtëpisë. Në këtë aktvendim, paditësja është paralajmëruar me pasojat ligjore në rast se nuk vepron brenda afatit të caktuar.

Pas kontrollimit të shkresave të lëndës, gjykata ka gjetur se aktvendimin e lartcekur, përfaqësuesja ligjore e paditëses e ka pranuar më datë 27.01.2025, afati i ka kaluar, ndërsa në shkresa të lëndës e as në regjistrin SMIL, deri në ditën e nxjerrjes së këtij aktvendimi, nuk ka arritur asnjë parashtrësë e paditëses.

Duke qenë se afati tashmë ka kaluar dhe paditësja nuk ka vepruar, Gjykata, duke u bazuar në nenin 102.3 të LPK-së, sipas të cilit “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hedhet poshtë”, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjyqtari,

Arben Xheladini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë Gjykatë.